



Npi – 01/345 datë: 31.10.2024

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) nenin 17 shkronja (k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Nenet 8, 9, 11, 12, 16 dhe 17 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin profesional dhe Punësimin e personave me aftësi të kufizuara; Nenet 6, 10, 11, 12 dhe 13 të Ligjit Nr.05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; Rregulloren e (MAPL) Nr.02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna; Nenin 14 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe duke u bazuar në nenin 11.1 të Rregullores Komunale për Transparencë Npi – 01/205 datë: 14.07.2017; Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më: 31.10.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR TA NXJERRË NË DISKUTIM PUBLIK DRAFT- STRATEGJINË DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR PËR PERIUdhËN 2025-2028

I

Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -X- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më: 31.10.2024, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Strategjinë dhe Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuara për periudhën 2025-2028. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/335 dt. 29.10.2024. Si dhe Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/338 të datës: 30.10.2024.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi